



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS**

---

|                           |                     |                              |            |
|---------------------------|---------------------|------------------------------|------------|
| <b>Numri i Ceshtjes :</b> | 71041-01954-11-2016 | <b>Data e Regjistrimit :</b> | 04/11/2016 |
| <b>Numri i Vendimit:</b>  | 11-2016-6014        | <b>Data e Vendimit :</b>     | 23/12/2016 |

**VENDIM**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS E PËRBËRË NGA:**

**GJYQTAR:** Petraq Çuri

**SEKRETARE:** Eriola Gashi

Sot më datë 23/12/2016mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen penale që i përket :

Kërkues {...}, i biri i {...} dhe i {...}, i datëlindjes {...}

**Objekti:**Heqjen e sekuestros per shumen {...} euro te depozituar ne Llogarine bankare te noteres Albana Hoti prane {...} Bank per llogari te shtetasit {...}, dhene nga Prokuroria prana Gjykates se Rrethit Gjyqesor Durres, me vendimin e sekuestrimit te dates 14.09.2016.

**Baza Ligjore:**Nenet 210 e vijues te K.Procedures Penale.

Gjykata pasi shqyrtoi në tërësi çështjen dhe pasi administroi provat dhe aktet e ndodhura në dosje, dëgjoji :

Avokatin mbrojtës që kërkoi pranimin e kërkesës;

Kërkuesin {...}, i cili kërkoi pranimin e kërkesës.

Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, që kërkoi rrëzimin e kërkesës;

**VEREN :**

Vëren:

Kërkuesi {...}, ka paraqitur kërkesë para kësaj gjykate, me objekt:

*Heqjen e sekuestros për shumën prej {...} euro, në llogarinë bankare të noteres Albana Hoti, pranë {...} Bank për llogari të {...}, dhënë nga prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin e sekuestrimit datë 14.09.2016.*

Konstatohet se çështja është në juridiksionin gjyqësor dhe kompetente për gjykimin e saj është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.

***Nga shqyrtimi i çështjes rezultoi se:***

Kërkuesi {...}, parashtroi në kërkesën e tij drejtuar gjykatës se me kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr.1563 rep dhe nr.959 kol datë 07.09.2016, i ka shitur shtetasit {...} një pasuri truall me sipërfaqe prej 1607,1m2 me nr.pasurie 35/103,ZK 8518 e ndodhur në lagjen 13 Plazh Durrës për shumën prej {...} euro.

Pala blerëse {...} këtë shumë e ka derdhur në llogarinë e noteres Albana Hoti me nr.9- {...} IBAN {...} {...}BANK.

Nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, është filluar procedimi penal në ngarkim të shtetasit {...} me urdhërin datë 14.09.2016, për veprën penale "Pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Më vendimin datë 14.11.2016, është vendosur sekustrimi i dokumentacionit kurse me vendimin e mëparshëm datë 14.09.2016, është realizuar sekustrimi i shumës prej {...} euro në llogarinë e noteres Albana Hoti, dhe të përmendur më sipër.

Nga ana e gjykatës u thirr edhe noterja Albana Hoti bazuar kjo në nenin 218 të KPP, i cili shprehet: "Rregullat për kthimin e sendeve të sekuestruara.

1.....

**2.Kur sendet janë sekuestruar pranë një të treti, kthimi nuk mund të urdhërohet në dobi të të tjerëve, pa u dëgjuar i treti nga gjykata.**

....."

Gjykata vlerëson se kërkuesi {...} legjitimohet në kërkimin e tij në konceptim procedural penal, konformë nenit 212 të KPP, në të cilit thuhet:

***"Kundërshtimi i vendimit të sekuestrimit.***

**1.I pandehuri, personi tek i cili janë sekuestruar sendet dhe ai që ka të drejtën e kërkimit të tyre, mund të bëjnë ankim në gjykatë kundër vendimit të sekuestrimit."**

*Gjykata pasi shqyrtoi aktet e provat shkrësore, dëgjoi palët, arrin në përfundimin se kërkesa nuk duhet të pranohet, për këto arsye:*

1.1 Pranohet se midis kërkuesit {...} dhe shtetasit {...} është lidhur një kontrata shitblerje e përmendur më sipër, ku nga ana e shtetasit {...} është paguar shuma prej {...} euro, e cila është depozituar në llogarinë e noteres Albana Hoti.

1.2 Mbi këtë shumë, nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, është vendosur sekuestro dhe ajo figuron akoma në llogari të shtetasit {...} nuk ka kaluar në llogarinë e kërkuesit.

1.3 Rezulton se pasuria 35/103 ZK 8518 prej 1607,1m2 truall, ka kaluar në pronësi të shtetasit {...} në ZVRPP Durrës, por nga ana e prokurorisë kjo pasuri nuk është sekuestruar.

1.4 Ndodhur në këto rrethana gjykata vlerëson se sekustrimi i shumës prej {...} euro nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, është i ligjshëm deri në përfundimin e hetimit lidhur me këtë shtetas.

1.5 Kërkuesi {...} ka mundësi të tjera ligjore, ai mund t'i drejtohet gjykatës për të kërkuar zgjidhjen e kontratës së shitjes së këtij trualli përmospagim të shumës së blerjes nga blerësi {...}

konformë nenit 705 e vijues të Kodit Civil,dhe prona e shitur të kalojë përsëri në emrin e tij,duke kërkuar nga gjykata civile edhe vendosjen e sekuestros preventive mbi këtë pasuri, e cila aktualisht figuron në emrin e shtetasit {...}..

### Për këto arsye

**Baza Ligjore:**

**Gjykata pasi pa dhe nenin 210,211,212,e vijues të KPP,;**

### VENDOSI:

Vendosi:

Të rrëzojë kërkesën e kërkuarit {...},me objekt:

Heqjen e sekuestros për shumën prej {...} euro,në llogarinë bankare të noteres Albana Hoti,pranë {...} Bank për llogari të {...},dhënë nga prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës,me vendimin e sekuestrimit datë 14.09.2016,*si të pabazuar në ligj.*

Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 10 ditëve,nga e nesërmja e shpalljes, në Gjykatën e Apelit Durrës.

Durrës, më 23.12.2016

### SHPENZIMET GJYQESORE

|                 |     |
|-----------------|-----|
| Kërkesëpadia    | 0   |
| Taksa Gjyqësore | 200 |
| Noterizime      | 0   |
| Njoftime        | 0   |
| Akt ekspertimi  | 0   |
| Avokat          | 0   |
| Gjithsej        | 200 |

**GJYQTAR:**

**Petraç Çuri**